

## **Vendim nr. 34, datë 28.01.2026**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Ilir Toska, Anëtar

Genti Ibrahimi, Anëtar

në datën 28.01.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 18 (I) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** ILIR MUZHAQI

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-469, datë 20.03.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi në datën 31.08.2020 ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ndaj ish-Prokurores së Përgjithshme, I.R., për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (KP). Sipas kallëzimit të kërkuesit, veprimi i paligjshëm konsiston në dhënien e

autorizimit nga ish-Prokurorja e Përgjithshme drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale në Prokurorinë e Përgjithshme, i cili në vendimin e datës 20.02.2012 të marrë prej tij nuk ka paraqitur asnjë dispozitë procedurale ligjore që pala ankimuese përveç ankimit në gjykatë mund t'i drejtohet edhe Prokurorisë së Përgjithshme për të njëjtin objekt ankimi pa ndonjë afat të përcaktuar.

2. Pas kryerjes së veprimeve verifikuese të kallëzimit Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), me vendimin e datës 11.09.2020, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. 167 të vitit 2020, duke vlerësuar se nga verifikimet e kryera arrihet në përfundimin se pretendimet e paraqitura në kallëzim nuk përmbajnë elementet e veprës penale “Shpërdormi i detyrës” ose të ndonjë vepre tjetër penale. Për këtë arsye, kërkuesi në datën 23.09.2020 i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), duke kundërshtuar këtë vendim të Prokurorisë së Posaçme për mosfillimin e procedimit penal.

3. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 349, datë 02.11.2020, ka vendosur mospranimin e ankimit për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e kërkuesit, duke lënë në fuqi vendimin e Prokurorisë së Posaçme. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, rezulton se pretendimet e paraqitura në ankim, ashtu sikurse edhe në kallëzimin nr.167 të vitit 2020, nuk përmbajnë elementet e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së, ose të ndonjë vepre tjetër penale, dhe me të drejtë organi i prokurorisë ka vendosur mosfillimin e hetimeve në lidhje me kallëzimin penal. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

4. Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 111(87-2023-168), datë 18.07.2023, ka lënë në fuqi vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë si të bazuar në ligj dhe në prova. Sipas GJKKO-së së Apelit, vendimi i shkallës së parë është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural penal të zbatueshëm dhe është produkt i një vlerësimi ligjor të plotë, por edhe shterues të pretendimeve të palës kallëzuese në raport me të dhënat referuese/provuese të kallëzimit dhe dokumentacionin e administruar nga Prokuroria e Posaçme në kuadër të verifikimit të këtij kallëzimi penal. Ndaj këtij vendimi ka bërë rekurs kërkuesi.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-469, datë 20.03.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të përcaktuara në nenin 432 të KPP-së. Kërkuesi, nëpërmjet rekursit, nuk ka arritur të argumentojë shkelje të ligjit penal procedural ose material nga GJKKO-ja e Apelit, si dhe nuk rezulton që vendimi objekt rekursi të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

6. Në datën 10.11.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, në drejtim të:

7.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e ka shqyrtuar çështjen brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në rekurs, sipas nenit 434, pika 1, të KPP-së, si dhe nuk i ka kërkuar atij memorie me shkrim, sipas parashikimit të nenit 432, pika 2, të KPP-së.

7.2. *Parimit të paanshmërisë*, pasi në përbërje të trupit gjykues në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë gjyqtari I.P., i cili ka qenë në kushte papajtueshmërie, pasi ka shqyrtuar disa kërkesa të tjera të paraqitura nga kërkuesi, si dhe nuk rezulton të ketë hequr dorë nga shqyrtimi i çështjes, për shkak se ka shfaqur mendimet dhe vlerësimet e tij për proceset e mëparshme.

7.3. *Gjykimin në mungesë*, pasi në gjykimin e çështjes në GJKKO-në e shkallës së parë kërkuesi nuk ka qenë i pranishëm për shkak të pandemisë. Gjithashtu, ajo gjykatë ka vendosur në mungesë rrëzimin e kërkesës së kërkuesit, duke lënë në fuqi vendimin për mosfillimin e procedimit penal. Sipas kërkuesit, nëse do të kryheshin hetime nga Prokuroria e Posaçme do të konstatoheshin elementet e veprës penale të shpërdorimit të detyrës nga ish-Prokurorja e Përgjithshme.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

#### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor penal që ka vendosur mosfillimin e procedimit penal të regjistruar mbi kallëzimin penal të paraqitur nga ai. Për rrjedhojë, nga pikëpamja procedurale, kërkuesi e justifikon interesin e tij në çështjen e parashtruar, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara.

10. Për sa i përket aspektit substancial të legjitimitetit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real.

11. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor në përfundim të të cilit është vendosur mosfillimi i procedimit penal dhe në këtë kuptim mosndjekja penale e personit të kallëzuar prej tij. Në thelb, ai ka kundërshtuar vendimin e prokurorit për mosndjekjen penale të personit të kallëzuar prej tij për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, të parashikuar nga neni 248 i KP-së. Në lidhje me këtë gjykatat kanë arritur në përfundimin se me të drejtë Prokuroria e Posaçme ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi faktet e kallëzuar, në ngarkim të së kallëzuarës, nuk përmbajnë elemente të veprës penale, të parashikuara nga neni 248 i KP-së. Sipas atyre gjykatave, nuk konstatohet kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve apo mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës nga shtetasja e kallëzuar.

12. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me paligjshmërinë e veprimeve të së kallëzuarës prej tij, ndaj në rrethanat e rastit konkret procesi penal duket se nuk mund të sjellë pasojat materiale që kërkuesi synon, por ai nuk e kushtëzon atë (kërkuesin) në përdorimin e mjeteve ligjore për mbrojtjen e të drejtave substanciale që ai pretendon se i janë shkelur. Nga ana tjetër, Kolegji evidenton se Kushtetuta nuk garanton të drejtën për të filluar ndjekjen penale kundër personave të tretë ose për dënimin e tyre, në të njëjtën mënyrë sikundër është shprehur edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me mbrojtjen e të drejtave konventore në këtë drejtim (*shih Renata Mckay-Kopecka kundër Polonisë, datë 19.09.2006*).

13. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kallëzimi penal ndaj personave të tretë nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar interesin e kërkuarit në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptimin që vendimet dhe procesi i kundërshtuar të sjellin pasoja reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore individuale të tij. Për rrjedhojë, kërkuari nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

14. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.